



T | PRVW00 | 1

ZALIJEPITI NALJEPNICU UÇENIKA



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE

QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2025-2026

UDHËZIME

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË: 70 MINUTA.

Mjetet e lejuara: lapsi grafit, goma dhe stilolapsi.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore. Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse gabon në zgjidhjen e detyrës, vijëzoje dhe zgjidhe përsëri.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Zgjidhjen e detyrës/pyetjes DUHET patjetër ta shkruani në vendin e paraparë për atë detyrë/pyetje.

GJATË PUNËS NË TEST NUK LEJOHET PËRDORIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE DHE KORREKTUESIT.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- ▶ është e pasaktë
- ▶ zgjidhja është shkruar në vendin që nuk është parashikuar për atë detyrë/pyetje
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë
- ▶ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë.

TË UROJMË SHUMË SUKSES!



T | PRV00 | 2

MOOMIN 80

*The door is
always open*



Me kënaqësi ju ftojmë në hapjen e ekspozitës
"80 vjet rrëfimi për Muminrollët"
Më 9 tetor në orën 10
QKI "Budo Tomoviq", Vaka Gjuvoviqa 12, Podgoricë

9-17 tetor 2025

(përshtatur sipas: <https://kicpodgorica.me/izlozba-80-godina-prica-o-muminima/>)

Në bazë të tekstit dhe ilustrimit, përgjigju pyetjeve 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Ambasada e Finlandës në Beograd dhe QKI "Budo Tomoviq" nga Podgorica organizojnë ekspozitën **"80 vjet tregime për Muminrollët"**, kushtuar personazheve të famshme të krijuara nga shkrimtarja dhe ilustratorja finlandeze **Tove Jansson**, e cila me veprat e saj ka shënuar fëmijërinë e brezave të tërë në mbarë botën.

1



P | YW69J | 2

Teksti është:

1. artistik
2. joartistik

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



T | PRVW00 | 3



P | MEKHD | 3

2

Përshkruaje fjalën me të cilën do të vërtetosh se teksti në ilustrim është ftesë.

1



P | 5N6RZ | 3

3

Trego arsyen e ftesës.

1



P | ME8GG | 3

4

Kush fton dhe kë fton?

2



T | PRVW00 | 4



P | PSHDA | 4

5

Në ilustrim janë dhënë dy data (9 tetor dhe 9 – 17 tetor 2025). Shpjego pse.



P | 8WU58 | 4

6

Rretho numrin para datës së shkruar saktë.

1. nga 9. deri më 17.tetor 2025.
2. nga 9 deri më 17. teor 2025
3. nga 9 deri më 17 tetor 2025
4. nga 9. deri më 17. X.2025



P | BEDBL | 4

7

Nga fjalët e dhëna përshkruaj mbi vija apo nënvizo fjalët e shkruara saktë.

pa aftësi pashmangësi i pa vërtetë pa pritmas
bashkëbisedim bashkë mendimtar bashkë jetesë

**Lexo fragmentin e dhënë dhe pastaj përgjigju pyetjeve 8, 9, 10 dhe 11.**

Mbrëmë pashë ëndërr se më kishin futur në burg. Ëndrra ishte e gjatë dhe e mërzitshme, kurse përtej saj shtrihej një zbrazësinë e përhime, ose e verdhë, ose krejt e pangjyrë.

Mëngjesi erdhi i vonuar, me një dritësim të mugët dhe të mjegullt, dhe me një qiell që kishte rënë fare poshtë. Në të vërtetë, një mëngjes të këtyllë dukej se e kisha krijuar vetë dhe kësaj më mbeti në kujtesë. Kur e hapa perden e dritares, në vend që të shikoja qiellin dhe peizazhin e zverdhur nën të, siç bëja zakonisht, në dritaren time pashë hekura të kryqëzuar, hekura të ndryshkur, hekura të vënë shpejt e shpejt dhe të përforcuar anash pas murit të shtëpisë. Gati duke rendur dola në dhomën tjetër dhe me vrull e largova perden nga dritarja (ishte një perde prej basme të trashë, kjo më kujtohet mirë, nga ato perde që krijojnë gjysmerrësirën e ftohtë në të gjitha dhomat e shtëpisë sime) dhe atje, përtej xhamave dhe përtej dritares, por këtej qiellit me dritësim të pakët dhe këtej pamjes dimërore të qytetit, diku në atë kufirin e padukshëm të idesë se jam i lirë dhe se liria nuk ekziston, ishin vënë po ato hekura të kryqëzuar e të ndryshkur, gjithandëj të përforcuar pas murit të shtëpisë.

Nuk e hapa asnjërën dritare dhe as më shkoi mendja të shihja se çfarë kishte ndodhur jashtë gjatë natës së shkuar. Përse ta bëja këtë? Ajo natë kishte qenë si të gjitha natët e jetës sime, e errët, e ftohtë për këtë stinë, pashpjegueshëm e errët dhe e ftohtë për të gjitha stinët, sikur të ishte stisur enkas për ndodhi të mërzitshme dhe për ëndrra po aq të mërzitshme.

U ktheva në shtratin tim, duke tërhequr këmbët zvarrë mbi dysheme dhe u shtriva me fytyrë të kthyer nga muri, për të gjetur mbi verdhësinë e tij të ndotur po ato njollat e gjithmonshme, nëpër të cilat kaloj pa vështirësi dhe futem në një botë të patrajtshme, në një botë amebash dhe gjolesh të pështirë, atje ku fillon gjeneza e të gjithave.

8

P | HV3EC | 5

Shkruaj titullin e veprës nga e cila është shkëputur ky fragment dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

2



T | PRV00 | 6



P | WDXVB | 6

9

Ngjarja në fillim të kësaj pjese lidhet me:

1. një bisedë
2. një ëndërr
3. një udhëtim
4. një vizitë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1

10



P | UGKCB | 6

Përsëritja e fjalës “hekura” në tekst shërben për të:

1. krijuar dialog
2. treguar vendndodhjen
3. theksuar idenë e izolimit
4. zbukuruar përshkrimin

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



T | PRV00 | 7



P | 3DRW7 | 7

11

Nëse pohimi është e saktë rretho S, nëse është i pasaktë rretho P.

Perdja e trashë që krijon gjysmerrësirë simbolizon izolim dhe fshehtësi.	S	P
Zbrazësia dhe hapësira e pafund përtej ëndrrës tregojnë shpresë dhe optimizëm.	S	P
Tregimi tregon se frika dhe kufizimet ekzistojnë vetëm në ëndrrën e personazhit dhe nuk lidhen me realitetin.	S	P
Ngjyrat e zbehta dhe qielli i ulët nuk ndikojnë në perceptimin emocional të lexuesit.	S	P

1

12



P | JX2R5 | 7

Trego se çfarë është ideja figurative e formës bisedore të fjalës *drejtoruc* dhe cili është kuptimi i saj.

2

**Lexo fragmentin nga poezia "Perëndim dielli në verë" të Asdrenit dhe puno detyrat 13 dhe 14.**

Sa pamje e bukur dhe madhështore,
Sa magji shfaqet që s'ka mbarim,
Natyra duket më vjershëtore
Me aq ndryshime plot me pëlqim.

Si disk i zjarrtë perëndon dielli,
Tej retë e malet flake i ngjyron,
Skuqet e mverdhet përpjetë qielli
Një zjarr vullkani sikur kullon.

13

P | LEC35 | 8

Cilën figurë stilistike dallon në dy vargjet e para të poezisë, cilën strofë dhe rimë përdor autori në strofën e parë?

Figura stilistike e përdorur në dy vargjet e para

Strofa dhe rima e përdorur në strofën e parë

2

14

P | ZDJJS | 8

Çfarë gjendjeje shpirtërore përcjell poeti në këtë fragment?

1. Trishtim dhe ankth, si pasojë e natyrës së largët dhe të paarrtshme.
2. Mahnitje dhe admirim të thellë për bukurinë e natyrës.
3. Zemërim dhe revoltë ndaj ndryshimeve të natyrës ose kohës.
4. Qetësi dhe lodhje, duke reflektuar mbi rutinën e përditshme.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1



T | PRV00 | 9



P | GM7U3 | 9

15

Në bazë të vargjeve plotëso tabelën.

VARGJET	TITULLI I TEKSTIT	AUTORI
“Pres një shenj’ e pres një dritë, Pres me vjet’ e pres me ditë, Seç u treta, seç u mpaka, Se u çora, seç u mplaka”		
“Përse të kam marrë grua? Gratë për punë po janë.”		
“Koha është të duhemi të kesh besim në mua kur të them: Trime, të kem besim në ty kur më thua: Trim”		

3

16



P | 7TAN8 | 9

Pranë fragmentit nga vepra letrare shkruaj se cilit lloj letrar i përket vepra.

1. Flamujt valëviteshin nëpër duart e tregtarit si zogj të kuq që kërkonin të fluturonin. Ai i shpaloste me kujdes, duke u dhënë shkëlqim në dritën e diellit, ndërsa sytë i ndizeshin nga një mall i çuditshëm. Për të, ato copa pëlhure nuk ishin thjesht mall për shitje, por shenjë e një shprese që rritej në heshtje në zemrat e njerëzve.

2. PRINC ROGANI

O Mandushiq, çfarë dreqin po ke,
Që gjithë natën me dikë po flet?

3. Gjenerali e ndjeu baltën që i ngjitej pas çizmeve dhe mendoi se kjo tokë e lagësht nuk do t'i kthente kurrë të gjithë ata që kishte ardhur të kërkonte. Era frynte e ftohtë mbi varrezat e përkohshme, ndërsa ai shfletonte listat me emra, si të ishin harta të një bote të humbur.

1



T | PRVW00 | 10



P | AC5QJ | 10

17

Nëse skena e filmit është xhiruar nga perspektiva e zogut, cili element i krijimtarisë filmike është përdorur nga regjisori?

1. plani
2. kuadri
3. rakursi

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1

18



P | MZTD6 | 10

Përcakto rasën e fjalëve të nënvizuara.

Ajo me veprat e saj ka shënuar fëmijërinë e shumë brezave.

veprat _____
 fëmijërinë _____
 brezave _____

1

19



P | EMVLS | 10

Plotëso fjalinë me mbiemrin pronor të emrit në kllapa.

Shtegtarët nga Evropa çdo vit e ndryshojnë botën shumëngjyrëshe të zogjve _____ (AFRIKA)

Të gjithë jemi të ftuar në ditëlindjen _____ (BRIKENËS)

1



T | PRVW00 | 16

